

DEKRET
Nr.7406, datë 31.7.1990

PËR MBROJTJEN E INVESTIMEVE TË HUAJA NË RPS TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës;
Me propozimin e Këshillit të Ministrave

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë mund të kryhen investime dhe veprimtari ekonomike që lidhen me to, nga ndërmarrjet, firmat, personat fizikë të huaj ose shqiptarë me banim jashtë territorit të RPSSH në përputhje me legjislacionin që rregullon këto veprimtari.

Investimet e huaja në territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë gëzojnë mbrojtje dhe sigurim të plotë.

Neni 2

Termi “investime” përfshin:

- a) pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme;
- b) aksionet në veprimtari të ekonomike me pjesëmarrjen e kapitalit të huaj;
- c) detyrimet në të holla (para) që janë përdorur për krijimin e një vlere ekonomike ose detyrimet e çdo lloji, që kanë vlerë ekonomike;
- ç) investimet tregtare, investimet për kërkimin, nxjerrjen dhe shfrytëzimin e pasurive natyrore si dhe lloje të tjera investimesh.

Neni 3

Investimet e huaja në territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë nuk shpronësohen, nuk shtetëzohen dhe nuk do të jenë objekt i ndonjë mase tjetër të njëjtë me shpronësimin ose shtetëzimin me përjashtim të rasteve të veçanta për qëllime publike dhe gjithmonë kundrejt pagesës së shpërblimit përkatës.

Shpërblimi për rastet e përmendura në paragrafin e parë të këtij neni, është i barabartë me vlerën e investimit të shpronësuar ditën që i bëhet i njohur palës tjetër dhe ky kompensim paguhet pa vonesë, me interesa të zakonshme bankare në kohën e pagesës. Ai është plotësisht i realizueshëm dhe i transferueshëm lirisht.

Në rastin kur kompensimi vonohet, ai paguhet me një shumë, e cila e vë investitorin në një pozitë jo më pak të favorshme se pozita, në të cilën ai do të ishte, nëse shpërblimi do t'i paguhej menjëherë në datën e shpronësimit. Klauzolat për mënyrën e pagesës së këtij shpërblimi duhet të bëhen përpara kohës së shpronësimit.

Neni 4

Ligjshmëria e shpronësimit, e shtetëzimit ose ndonjë masë tjetër e barbartë me to, si dhe shuma e shpërblimit, mund të jenë objekt shqyrtimi i një procesi të caktuar gjyqësor.

Neni 5

Ndërmarrjeve, firmave ose personave fizikë të huaj, investimet e të cilave pësojnë humbje në

territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë për shkak të luftës, të gjendjes së jashtëzakonshme, si dhe forcave të tilla natyrore, si tërmetet, përmbytjet etj., u bëhet i njëjti trajtim si edhe ndërmarrjeve të saj lidhur me dëmshpërblimet, shpërblimet etj.

Neni 6

Pagesat sipas nenit 3 bëhen pa vonesë, me kursin e zbatueshëm të shkëmbimit në datën e pagesës.

Neni 7

Fitimet nga investimet në rast të riinvestimit të tyre gëzojnë të njëjtën mbrojtje si dhe investimet.

Neni 8

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë do të nxitë frymën e mirëbeimit e të bashkëpunimit për zgjidhjen e shpejtë e të drejtë të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet palëve investuese. Nëse kjo nuk arrihet, me kërkesën e njëres palë, çështja i paraqitet arbitrazhit të zgjedhur prej tyre.

Neni 9

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë do t'i bëjë të njohura publikisht të gjitha ligjet, rregullat dhe procedurat që kanë të bëjnë ose ndikojnë mbi investimet.

Neni 10

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE
TË SHQIPËRISË

SEKRETARI
SIHAT TOZAJ

KRYETARI
RAMIZ ALIA